

Kuadri ligjor i BE-së për barazinë (gjinore)

- Entela Baci (Hoxhaj)
- Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
- European Equality Law Network
- ERA – Tiranë – 4 Qershor 2026
- (Seminar për Anëtarë të Sistemit Gjyqësor)



1

Çështjet që do të trajtojmë:

- I. Pak histori për legjislacionin për barazinë në BE
- II. Burimet e të drejtës evropiane për barazinë (gjinore). Vendi i Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së në hierarkinë e burimeve të së drejtës evropiane.
 - 1 Burimet e të drejtës evropiane për barazinë (gjinore)
 - 1.1 Barazia (gjinore) dhe mos-diskriminimi në TBE dhe TFBE:
 - 1.2 Karta e të Drejtave Themelore të BE-së si burim primar dhe parashikimet e saj për barazinë (gjinore)
 - 2. Direktivat e BE-së për barazinë gjinore dhe mos-diskriminimin
 - 3. Jurisprudenca e GJDBE dhe parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së
- III. Efekti i drejtpërdrejtë horizontal i nenit 21 të Kartës së të drejtave të BE në jurisprudencën e GJDBE-së.
 - 1. Kur zbatohet Karta në nivel kombëtar?
 - 2. Jurisprudenca GJDBE për nenin 21.

2

2

I. Pak histori për legjislacionin për barazinë në BE

- 1957 – Neni 119 i Traktatit të KEE (tani, neni 157 TFBE)

(Mirënjohje për Álvaro Oliviera
për ndërgjegjësimin
për këtë foto gjatë
një seminari të EELN)



This Photo is licensed under CC BY-SA

3

3

Rastet Defrenne përpara GJED

- Historia e një stjuardese kundër kompanisë ajrore
- Defrenne kundër Sabenna
- Defrenne 1 – 1971
- Defrenne 2 – 1976
- Defrenne 3 – 1978 > Barazia si një parim i përgjithshëm i së drejtës

4

4

● I. Burimet e të drejtës evropiane për barazinë (gjinore)

1. Burimet primare (traktatet): TBE, TfBE, Karta e të Drejtave Themelore të BE

2. Burimet sekondare (Direktiva e Rregullore)

3. Burime të tjera:

1. Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së (GJDBE)
2. Parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së
3. Marrëveshjet ndërkombëtare (KEDNJ, Konventa e Stambollit, Deklarata Universale e të Drejtave të njeriut, etj.)

5

5

1.1 Barazia (gjinore) dhe mos-diskriminimi në TBE dhe TFBE:

**Barazia si vlerë
themeluese në
BE:**

- (1) **Në preambul, TBE** – barazia si një nga vlerat universale të Evropës;
- (2) **Neni 2, TBE** – Barazia si një vlerë në themel të BE; barazia mes burrave e grave dhe mos-diskriminimi si vlera të përbashkëta të shoqërisë së shteteve anëtare.

**Mos-diskriminimi
dhe barazia mes
burrave dhe
grave si qëllim:**

- **Neni 3(3), TBE** – lufta ndaj diskriminimit dhe promovimi i barazisë gjinore
- **Neni 8, TFBE** – promovimi i barazisë mes burrave e grave
- **Neni 153(i), TFBE** – barazi në mundësitë në tregun e punës dhe në punë.
- **Neni 157, TFBE** – barazi në paga.

6

6

1.1 Barazia (gjinore) dhe mos-diskriminimi në TBE dhe TFBE:

Barazia dhe mos-diskriminimi si parime:

- **Neni 9, TBE** – parimi i barazisë së të gjithë qytetarëve të BE.
- **Nenet 10, 18 e 19, TFBE** – Mosdiskriminimi për shkaqet: shtetësi, **gjini**, racë, etni, besim ose bindje fetare, aftësia e kufizuar, mosha, orientimi seksual.

Barazia gjinore si e drejtë:

- **Nenet 10, 19, TFBE** – e drejta për trajtim të njëjtë pavarësisht gjinisë.
- **Neni 157, TFBE** – e drejta për pagë të njëjtë mes burrave e grave.

7

1.2 Karta e të Drejtave Themelore të BE-së si burim primar dhe parashikimet e saj për barazinë (gjinore)

Karta ka hyrë në fuqi në vitin 2009 pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës

Neni 6(1) i TBE

Karta do të ketë të njëjtën vlerë ligjore si Traktatet.

Jurisprudenca e GJDBE i ka dhënë efekt të drejtpërdrejtë horizontal disa dispozitave të Kartës në disa raste: nenet 21, 31(2) dhe 47.

8

8

Çfarë parashikon Karta e të drejtave themelore të BE-së për barazinë (gjinore)?

Neni 20

- Barazia para ligjit

Neni 21

- Mos-diskriminimi (gjinia dhe shkaqe të tjera – listë e mbyllur)

Neni 23

- Barazia mes burrave dhe grave (në të gjitha fushat, jo vetëm në punësim), si dhe masat pozitive.

Neni 51(1)

- Fusha e zbatimit: Karta aplikohet nga institucionet e BE-së dhe Shtetet anëtare kur zbatojnë legjislacionin e BE-së

9

9

2. Direktivat e BE-së për barazinë gjinore dhe mos-diskriminimin

Përmbledhje e 3 slideve që vijnë fill më pas:

Paraqiten 13 direktiva në fuqi, nga të cilat:

2 janë për mos-diskriminimin,

gjithë të tjerat janë për barazinë gjinore.

Zhvillimet e vitit të fundit:

2024: Janë miratuar Direktivat 2024/1499/BE dhe 2024/1500/BE

Janar 2025: Komisioni Evropian tërhoqi propozimin për Direktivën Horizontale të trajtimit të = (pas 17 vitesh stanjacion)

Mars 2026: Miratimi i Strategjisë së BGJ 2026-2030

10

10

2. Direktivat e BE-së për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin

Direktiva 79/7/KEE

➤ për zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë mes burrave dhe grave në fushën e sigurimeve shoqërore.

Direktiva 92/85/KEE

➤ për punonjëset shtatzëna ose që sapo kanë lindur apo po ushqejnë fëmijën me gji.

Direktiva 2000/43/KE
(e ndryshuar)

➤ për barazinë e racave ose etnive.

Direktiva 2000/78/KE

➤ për barazinë dhe mosdiskriminimin.

11

11

Direktivat (...)

Direktiva 2004/113/KE
(e ndryshuar)

➤ për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Direktiva 2006/54/KE
(e ndryshuar)

➤ për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave e grave në çështjet e punës dhe punësimit.

Direktiva 2010/41/BE
(e ndryshuar)

➤ Për barazinë dhe mos-diskriminimin në vetë-punësim (në raport me çështje si barrëlindja dhe mbrojtja shoqërore).

Direktiva 2019/1158/BE

➤ e balancës punë-jetë për prindër dhe kujdestarë (leja për kujdes për të sëmurët, leja prindërore, puna me orare fleksibël, etj.).

12

12

Direktivat (..)

Direktiva
2022/2381/BE

➤ për barazinë gjinore në bordet e kompanive private (të listuara).

Direktiva
2023/970/BE

➤ për transparencën e pagave

Direktiva
2024/1385/BE

➤ për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Direktivat 2024/1499/BE
dhe 2024/1500/BE

➤ për standartet e organeve të barazisë në fushën e të mirave dhe shërbimeve, si dhe në fushën e punësimit.

13

13

3. Jurisprudenca e GJDBE dhe parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së

Supermacia e të drejtës së BE ndaj të drejtës së brendshme të Shteteve Anëtare, përfshirë normat kushtetuese:

- faza e parë, vetë jurisprudenca e GJED →, Kosta kundër Enel (1964), Internationale Handelsgesellschaft (1970), Amministrazione delle Finanze dello stato kundër Simmental (1978) etj;
- faza e dytë, zhvillimet në ligjet kushtetuese të shteteve anëtare dhe vendimet e disa Gjykatave Kushtetuese (GJK) të shteteve anëtare për qëllimet e ratifikimit të traktateve themeluese → ndryshimet kushtetuese në Francë, Gjermani, Spanjë e ndonjë tjetër; vendimet e GJK Çeke e Hungareze për përputhshmërinë e Traktatit me Kushtetutën, Vendimet e GJK Gjermane Solange I (1974) e Solange II (1986), etj.

14

14

3. Jurisprudenca e GJDBE dhe parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së

Parimi i Barazisë si një parim i përgjithshëm:

- Defrenne III : C-149/77, Defrenne kundër Sabrena: Barazia gjinore nuk është vetëm një e drejtë kontraktuale, por një parim i përgjithshëm i së drejtës.

Parimi i efektit të drejtpërdrejtë:

- çështja C-26/62, Van Gend en Loos (1963): Dispozitat e të drejtës së BE mund të krijojnë të drejta dhe detyrime për individët, të cilat ata mund t'i pretendojnë përpara gjykatave kombëtare mes palëve private (horizontal) dhe ndaj shtetit (vertikal).

15

15

II. Efekti i drejtpërdrejtë horizontal i nenit 21 të Kartës së të drejtave të BE në jurisprudencën e GJDBE-së.

2.1 Kur zbatohet karta në nivel kombëtar?

- Shteti anëtar vepron brenda fushës së të drejtës së BE vetëm kur (neni 51):
 - Zbaton ose transponon ligjin – shembull;
 - kufizon të drejtat themelore duke u mbështetur në të drejtën e BE-së – shembull.
 - Një autoritet kombëtar vepron bazuar në të drejtën e BE-së – shembull;
- Shteti anëtar nuk vepron brenda fushës së BE-së kur:
 - Miraton ligje apo ndërmerr veprime që nuk lidhen me të drejtën e BE-së;
 - Po vepron në një nga fushat e BE-së , për të cilat kjo e fundit ka kompetencë por nuk ka vepruar akoma;
 - Transponon legjislacionin por vepron përtej kërkesave të përcaktuara në legjislacionin e BE-së

Jurisprudenca e GJDBE i ka dhënë efekt të drejtpërdrejtë horizontal disa dispozitave të Kartës në disa raste:

- Neneve 21, 31(2) dhe 47 të Kartës.

16

16

2.2 Jurisprudenca GJDBE për nenin 21.

Le ta përmbledhim shkurtimisht vendimarrjen përpara se të analizojmë çështje të veçanta:

- Karta përbën një standard për rishikimin e legjislacionit dytësor.
- Përkufizimi i të drejtave themelore duhet të jetë i pavarur.
- Veprimi i shtetit duhet të jetë brenda fushës të së drejtës së BE-së.
- Neni 21 është i detyrueshëm; ai është i mjaftueshëm, do të thotë nuk ka nevojë të merren masa të mëtejshme zbatuese.
- Neni 21 ka efekt të drejtpërdrejtë horizontal, do të thotë që individët mund t'i referohen direkt në mosmarrëveshjet mes palëve private.



17

17

Kushtet për aplikueshmërinë direkte të neneve 21 dhe 31 në jurisprudencën GJDBE:

Kushti 1 – çështja duhet të jetë brenda fushës së zbatimit të të drejtës së BE-së.

Kushti 2 – dispozita duhet të ketë në vetvete karakter detyrues dhe të pakushtëzuar:

- E drejta duhet të jetë njëherësh veti e detyrueshme dhe e pakushtëzuar
- Dispozita duhet të jetë e mjaftueshme në vetvete, do të thotë nuk duhet të ketë nevojë për masa (shprehje) konkrete me dispozita të legjislacionit të BE-së apo atij kombëtar

18

18

• C-144/04 Mangold (2005)

- Çështja ka të bëjë me diskriminim për shkak të moshës: Mangold, 50 vjeç, i punësuar me kontratë me afat të caktuar sipas një ligji gjerman që lejonte punësimin e personave mbi 52 vjeç me kontrata të tilla pa kufizime. Ai kërkoi diskriminim për shkak të moshës bazuar në Direktivën 2000/78.
- Gjykata vendosi se parimi i mosdiskriminimit është një parim i përgjithshëm i së drejtës së BE-së dhe mund të zbatohet drejtpërdrejt edhe në marrëdhëniet mes individëve (efekt horizontal të drejtpërdrejtë)

• C-555/07 Küçükdevci (2010)

- Çështja ka të bëjë me diskriminim për shkak të moshës, pushim nga puna dhe peirudhën e njoftimit: një ligj gjerman u mohonte të rinjve nën 25 vjeç periudhën e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit. Küçükdevci e kundërshtoi.
- Gjykata vendosi se neni 21 i Kartës ka efekt të drejtpërdrejtë horizontal dhe gjykatat kombëtare nuk duhet të zbatojnë ligje të brendshme që vijnë në kundërshtim me të

19

19

• C-414/16 Egenberger (2018)

- Vera Egenberger aplikoi për punë në bazë të një njoftimi për punë me afat të caktuar në një organizatë fetare gjermane. Aplikimi i saj u refuzua sepse nuk ishte anëtare e një kishe protestante. Ajo argumentoi se përkatësia fetare në raport me aplikimin për punë ishte shkak diskriminues dhe kërkoi diskriminim në punësim për shkak të fesë bazuar në Direktivën 2000/78.
- Gjykata vendosi: parimi i mosdiskriminimit për shkak të fesë është një parim i përgjithshëm i së drejtës së BE-së, prandaj **neni 21 i Kartës ka efekt horizontal të drejtpërdrejtë**. Gjykatat kombëtare kanë detyrimin të interpretojnë ligjet e tyre në përputhje me këtë parim dhe, **nëse është e nevojshme, të mos zbatojnë një ligj të brendshëm që bie ndesh me të.**

20

20

• C-193/17 Cresco (2019)

- Një ligj austriak i jepte një ditë pushimi të paguar punëtorëve që i përkisnin Kishës Protestante. Markus Achatz, punëtor në firmën Cresco, kërkoi që të paguhej për “ditë pushimi me pagesë” duke argumentuar se trajtimi i tij ndryshe ishte diskriminues.
- Gjykata vendosi se ligji austriak krijonte diskriminim mbi bazën e fees duke qenë në kundërshtim me nenin 21 të Kartës dhe Direktivën 2000/78/KE. Neni 21 është i detyrueshëm; ai është i mjaftueshëm, do të thotë nuk ka nevojë të merren masa të mëtejshme zbatuese. Austria duhet ose të zgjerojë të drejtën e pushimit për të gjithë punëtorët ose ta heqë përjashtimin për grupe specifike fetare.

21

21

Çështjet më të fundit përpara GJDBE lidhur me nenin 21 të Kartës

• C-408/23 Anwaltsnotarin (2024)

- Një juriste në Gjermani aplikoi për pozicionin e noteres në rrethin gjyqësor ku ajo ushtronte profesionin. Aplikimi i saj u refuzua për shkak se ajo kishte kaluar moshën 60 vjeç në momentin e aplikimit (kufi i përcaktuar nga legjislacioni gjerman)
- Gjykata vërejti se neni 6(1) Direktivës 2000/78/KE, i parë nën dritën e nenit 21 të Kartës, duhet interpretuar se nuk përjashton legjislacionin e brendshëm që vendos kufirin 60 vjeç sidomos meqë: (i) legjislacioni ndjek objektiva dhe politika punësimi të ligjshme dhe (ii) nën këtë kontekst, ai (legjislacioni) duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për arritjen e këtyre objektivave.

22

22

Çështjet më të fundit përpara GJDBE lidhur me nenin 21 të Kartës

• C-631/22, Ca Na Negreta (2024)

- Një punonjës me aftësi të përhershme të kufizuar në Spanjë hiqet nga puna për shkak se nuk mund të kryente detyrën për shkak të aftësisë së kufizuar pa iu ofruar mundësia e lëvizjes paralele, bazuar në nenin 49(1)(c) të Kodit të Punës Spanjoll, i paazhurnuar që nga 1980-a pavarësisht përparimit të legjislacionit për aftësinë e kufizuar.
- Gjykata vendosi se neni 5 i Direktivës 2000/78/KE, i parë nën dritën e nenit 21 të Kartës, dhe neneve 2 e 27 të Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duhet interpretuar si pengues i legjislacionit kombëtar i cili parashikon që **një punëdhënës mund të zgjidhë kontratën e punës me arsyetimin se punëtori është i pa aftë për gjithmonë të kryejë detyrat që i janë besuar në bazë të asaj kontrate, për shkak të një pa aftësie që ndodh gjatë marrëdhënies së punës, pa iu kërkuar fillimisht punëdhënësit të bëjë përshtatje të arsyeshme për ta mbajtur në punë ose të vërtetojë se një përshtatje e tillë do të përbënte një barrë joproporcionale për të.**

23

23

Çështjet më të fundit përpara GJDBE lidhur me nenin 21 të Kartës

• C-38/24, GL v. A.B. SpA (2025)

- Kjo çështje lidhet me aftësinë e kufizuar dhe një punonjës i cili nuk ishte për vete me AK por kujdesej për një fëmijë me AK
- Gjykata vendosi që legjislacioni i BE-së kundër diskriminimit mbron edhe nga diskriminimi indirekt për shkak të shoqërimit që lidhet me aftësinë e kufizuar.

24

24

JU FALEMNDERIT !

25

25

Informacione të tjera të nevojshme: ku të kërlesh për t'u azhornuar?

❑ European Commission, DG Justice and Consumers

Combatting discrimination: https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination_en

Gender equality: https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality_en

❑ The Court of Justice of the European Union

https://curia.europa.eu/jcms/jcms/Jo1_6308/

❑ European Court of Human Rights

<http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=home>

❑ European Equality Law Network publications

Tematic reports and comparative overview: <https://www.equalitylaw.eu/publications>

Legal developments and country reports në: <https://www.equalitylaw.eu/country>

26

26